



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 227, Datë 09.11.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/6 prot, datë 02.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1021 prot., datë 26.10.2021, ka paraqitur aplikimin për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” dhe “e”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërma “c” dhe “d”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika “b” dhe “c”. **Plotësuar.**

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- **gërma “c”** (Vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentin e plotë në formën e kërkuar nga Rregullorja (jo vetëm faqen e parë të dokumentit).
- **gërma “d”** (Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për administratorin e shoqërisë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. si dhe për administratorin e saj.
- **Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3: gërma “a”** (Vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të letrës mbështetëse të lëshuar nga Credins Bank me nr. 506 prot., datë 25.10.2021, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n nëse i ka plotësuar kriteret financiare të vendosura nga banka në kuadër të mbështetjes financiare që kjo e fundit do t’i mundësojë për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8:

- **gërmat “a” dhe “d”** (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve); **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria ka paraqitur sasinë e parashikuar për tu tregtuar për tre vite të licencës, por duhet të paraqesë në ERE edhe

sasitë e parashikaura për dy vitet e tjera të veprimtarisë së licencuar pasi afati i një licence është 5 vjet, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.